

Pas mbjelljes në çdo rresht, bëhet ujitje uniforme e bollshme. Gjatë procesit të shkëlqes, përgatitjes, mbjelljes dhe ujitjes së fidanëve të sherebelës duhet treguar kujdes i vazhdueshëm që gjethet e tyre të mos përlyhen me baltë ose me shurup plehu. Kjo ka rëndësi sepse ndikon në përqindjen e zënieve pas mbjelljeve në fushë. Në vëndet ku fidanët janë tharë ose mungojnë duhen bërë zëvendësimet me fidanë të tjerë. Në vazhdim ngastra e mbjellë do të mirëmbahet. Një herë në muaj është e domosdoshme të bëhen prashitje dhe tëharrje, ndërsa ujitjet duhen bërë sipas nevojave dhe aspak më tepër.

Vjelja, tharja, ambalazhimi dhe etiketimi

- Zhvillimi i bimëve dhe fillimi i lulëzimit gjatë sezonit të parë të jetës së tyre ndodh në muajin qershor. Bimët e sherebelës në këtë kohë kanë krijuar buqetat e plota të tyre dhe ndërkohë ka nisur shfaqja e kërcejve lulorë në masën 30%. Në këtë periudhë duhet bërë këputja e këtyre kërcejve për arsye se ata thithin një pjesë të lëndës organike duke pakësuar prodhimin e gjethëve.
- Vjelja e gjethes (buqetës)-Periudha më e mirë për të filluar vjeljen e buqetës së sherebelës është kur gjethet të ketë marrë ngjyrën gri në argjend. Buqetat korren me drapër të padhëmbëzuar ose kmesë në lartësinë rreth 5 cm mbi tokë për tu lënë mundësi bimëve të lëshojnë llastarë të shumtë të cilët, në të ardhmen e afërt, do të mbulojnë krejt sipërfaqen e mbjellë.
- Pas korrijës bëhet një ujitje e bollshme dhe pastaj vazhdohet me shërbimet e zakonshme të tëharrjeve e të prashitjeve.
- Vjelja e dytë e buqetave bëhet në periudhën shtator-tetor, në varësi nga kushtet e zonës dhe së motit. E tërë masa e buqetës së vjelë transportohet shpejt në vëndet e tharjeve.
- Tharja kryhet duke ekspozuar prodhimin e sapo vjelë në diell për 6-8 orë rresht, pas kësaj çohet në ambjente tharje të posaçme të hijëzuar dhe me korrente ajri.
- Tharja e buqetave të sherebës në verë zgjat 3-4 ditë, ndërsa në vjeshtë zgjat më tepër.

• Amabalazhimi i buqetës së tharë duhet të bëhet në thasë bezeje të cilët vendosen në mjedise të pastër, pa lagështirë, të lyer vetëm me shurup gëlqere viskoz. Thasët sistemohen në paleta druri të ngritura 10 cm mbi tokë. Dritaret e magazinës duhet të jenë të pajisura me sita mbrojtëse karshi insekteve të ndryshëm dhe herë pas here duhet të hapen gjatë ditës për efekt ajrimi.

• Etiketimi i thasëve do të bëhet sipas kërkesave të blerësit. Nëse blerësi kërkon buqetë të pastër, d.m.th. pa fije bari, pa lëndë të huaja, pa gjethë të dëmtuara nga insektet ose të pa 'ndryshkura' apo të kalbura etj., atëherë i gjithë prodhimi duhet t'i nënshtrohet procesit të përzgjedhjes (seleksionimit).

• Një sipërfaqe toke mund të qëndrojë e mbjellë me sherebelë deri në 5-6 vjet.

Vlerat ekonomike

Nga praktikat e deritanishme të kultivimit të sherebelës rezulton se, bazuar edhe në çmimet aktuale të grumbullimit, të cilat lëvizin nga 1.5-1.8 USD/kg masë e thatë bimore e papërpunuar, të ardhurat vjetore janë mbresëlënëse. Prodhimi i masës gjethore të thatë në një hektar shkon edhe në rreth 6 ton/ha/vit. Kostoja e prodhimit, që nënkupton totalin e shpenzimeve të përgjithshme të kultivuesit nga viti i parë deri në vitin e 5-të dhe/ose të 6-të, variojnë nga 800-1200 USD/ha. Ndërsa të ardhurat mesatare vjetore (rreth 6 ton/vit/ha x 1,5 – 1,8 USD/kg si masë e thatë = 9000 - 11000 USD), flasin për leverdinë ekonomike të kultivimit të kësaj bime në këto toka e zona, ku bimët e tjera nuk kanë rezultate.

Tregjet

Buqeta e sherebelës është ndër të paktët asortimente që ka treg vazhdimisht. Deri tani tregu i eksportit të sherebelës ka qenë i bazuar në produktin masë gjethore e thatë. Në një të ardhme të afërt janë të gjitha mundësitë e ngritjes së infrastrukturës së përpunimit të sherebelës dhe të eksportit të esencave, të cilat kanë premisa që të rrisin akoma më shumë interesin ekonomik të kultivimit të kësaj bime.

KONTAKT:

Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale
Email: fkpkkshqiperi@gmail.com, Tel: +355682077157



Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave
Komunale
Rr. Bulevardi Zogu I, Godina ZP Kati II-të
Tiranë – Shqipëri
Website: www.shkpkk.org



TEKNOLOGJIA E KULTIVIMIT

DHE

PËRPUNIMIT TË SHEREBELËS

**Përgatiti: Ing. Ferdin Liçaj
Ing. Arjol Lila**

Mbështeti:



Karakteristika të përgjithshme

Sherebela është bima që zë pjesën më të madhe të ek-sportit të bimëve medicinale në Shqipëri. Kushtet e fa-vorshme klimatiko-tokësore kanë bërë që Shqipëria të jetë një ndër furnizuesit kryesorë të tregjeve ndërk-ombëtare me sherebelë. Shkenca ka dëshmuar që shere-bela ka veprim antibakterial dhe antikërpudhor, freskon dhe forcon organizmin, ndihmon kundër dhembjeve dhe temperaturave të larta. Sherebela pastron gjakun, po ashtu ndihmon në nxjerrjen e sekrecioneve nga or-ganizmi. Bime me veti antiseptike, përdoret në shëri-min e aftit, erës së pakëndshme të gojës, problemeve të fytit dhe bajameve, kariesit dhe qelbëzimit të mishrave të dhëmbëve. Ka ndikim kundër të vjellave dhe diarresë së shpeshtuar, si edhe në funksionimin e zorrëve, stomakut, veshkave dhe parandalon formimin e endem-ave. Sherebela ndikon pozitivisht edhe për problemet femërore.

Kërkesat ndaj mjedisit të kultivimit

Temperatura: Sherebela mund t'u rezistojë tempera-turave të ulta deri -10°C.

Reshjet: Kultivohet mirë në zona me 500-1200 mm reshje në vit.

Diellëzimi: Preferon terrene me ekspozicion të gjatë ndaj diellit.

Erërat: Ka rezistencë të mirë ndaj erërave të ftohta me origjinë kontinentale.

Toka: Preferon toka të shkrufta të përshkueshme.

Solucioni tokësor: Kufijtë e pranuar të pH për kultivim 6.5-8.

Elementët ushqyes: Paraqet kërkesa ndaj makroelemen-tëve si Ca, K, P, N si edhe mikroelementëve si Fe, Mg, Cu etj.

Kultivimi

Sherebela mund të kultivohet me dy mënyra:

- me fidanë me prejardhje nga fara
- me fidanë me prejardhje nga copa vegjetative.

Nga praktika e derisotme është vërtetuar se kultivimi me fidanë të parapërgatitur është teknologji shumë më e suksesshme, prandaj rekomandohet të përdoret nga fermerët që dëshirojnë ta kultivojnë këtë bimë.

Nëpërmjet kësaj teknologjie garantohet mbjellje e qëndrueshme me rendiment shumë të lartë dhe mbirje uniforme në krye të 10-15 ditëve në kushte të kontrolluara të lagështirës, temperaturës, dritës, tokës dhe plehërimit, gjithashtu përdoret më pak material mbjellës.

Sigurohet prodhim më i hershëm e me rendimet më të madh.

Periudhat më të përshtatshme për mbjelljen janë :

1. 20 Gusht-1 Shtator (në vullaja pa mbulim)
2. 20 Janar-1 Shkurt (në shtretër të ngrohtë).

Përgatitja e farishtores

Gjatësia e vullajës 10-12 m, ndërsa gjërësia e saj 1.2m. Vullajat ngrihen mbi sipërfaqen e tokës e tokës deri në 10 cm. Ndërmjet vullajave lihen rrugica ndarëse 30-40 cm të gjëra. Vullajat ndërtohen me dhé të përzjerë me pleh or-ganik të kalbur mirë e të situar normalisht (mundësisht pleh dhije). Sasia e dheut dhe e plehut rekomandohet të jenë të njëjta. Vijat e mbjelljes së farës bëhen në drejtimin tërthor të vullajës dhe ato duhet të jenë paralele dhe me largësi 10 cm. Fara shpërndahet uniformisht përgjatë vijës, ku në çdo 5 cm hidhen 2 fara së bashku. Për 1 m² vullajë i takon 10 ml vijë e mbjellë, që do të thotë 10 gr farë apo ndryshe 40 fara/ml ose **400 fara/m²**, të cilat duhet të shpërndahen uniformisht përgjatë vijave. Rekomandohet lënia e farave pa i mbuluar për tri ditë me qëllim që t'i rrahë dielli, kjo bën që të rritet aftësia mbirëse të tyre. Mbulimi i farës duhet bërë uniforme me pleh e me dhé të thërrmuar imët. Rekomadohet t'i shtohet në përzjerje edhe pak pluhur gëlqereje (10 kg për 1 m³ përzjerje).

Ngjeshja bëhet uniformisht me një rul cilindrik të lëmuar. Trashësia e shtresës së dheut (pas ngjeshjes) që aplikohet për mbulimin e farave të mbjella rekomandohet të jetë 7-8 mm. Numri i fidanëve që sigurohet në farishtore për metër katror shkon mesatarisht **200 copë**. Menjëherë pas mbjelljes bëhet ujitje e bollshme me një enë ujitëse që e ka grykën në trajtë dushi. Ujitjet e tjera bëhen në varësi të pranisë së vlagës në tokë.

Kujdes! Bimët e sherebelës nuk e durojnë shumë lagështirën e tepërt të tokës sepse fillojnë e kalben.

Mbjellja e fidanëve

Periudhat e përgatitjes së fidanëve për t'u mbjellë në fu-shë janë përkatësisht:

- 20 Tetor-1 Nëntor
- 1-10 Prill.

Pasi fidanët shkulen nga farishtorja, u priten rrënjët e gjata me gërshërë për të mos lejuar përdredhjen e tyre gjatë mbjelljeve. Ato bashkohen në tufa të vogla me nga 10 fidanë, me fije bari ose me lidhëse të posaçme, pas kësaj fidanët banjëzohen në një enë ku kemi përgatitur më parë shurup të trashë plehu organik. Pas banjëzimit fidanët sistemohen në arka plastike ose prej druri të posaçme për t'u transportuar në vëndin e mbjelljes. Rekomandohet mbjellja e menjëherëshme e tyre, por nëse nuk ka mundësi, atëhere fidanët duhen shtratifikuar në anë të fushës, në vënd të mbrojtur nga era, nga reshjet dhe prej dëmtimeve të tjerë të mundshëm, por nuk duhet të rrinë në gjëndje shtratifikimi më tepër se 4 ditë. Fidanët mund të mbillen me skemën **40x30cm**, në këtë rast mbulimi i tokës bëhet më së miri dhe duhen rreth **8400 fidanë/dynym** ose me skemën **60x30cm** dhe sasia e fidanëve të nevojshëm për dynym shkon rreth **5550 copë**.

Mbjellja e fidanëve bëhet me një kunj druri me diameter 2 cm, me majë, me dorezë të kthyer të përgatitur enkas për këtë operacion. Vrima hapet deri në thellësisnë 5-6 cm, ku aty futen rrënjët e fidanit dhe një pjesë e vogël e qafës kërcellit të tij (rreth 1 cm).